



PROCESVERBALI

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **30.01.2015** me fillim në ora **10.15**. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Nahit Elshani**, i cili në fillim ka përshëndetur Kryetarin e komunës z. Idriz Vehapi, Nënkryetarin dhe dhe stafin e tij, delegatët e pranishëm, përfaqësuesit e OSBE-së, KDI-së, mediat, nxënësit e shkollës së mesme "Xhelal Hajda- Toni" dhe të pranishmit e tjerë. Për mbledhjen e sotme ka propozuar këtë:

Rend Dite

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Aprovimi i tejkallimit të të hyrave vetanake,
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për shpalljen e zonës së interesit publik për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Krushë të Madhe,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për shpalljen e interesit publikë për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale,
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për autorizimin e kryetarit për nënshkrimin e Marrëveshjes për mbulimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit,
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i statutit të QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec,
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i rregullores për taksa, tarifa, gjoba dhe ngarkesa,
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Rregullores për menaxhimin e mbeturinave.

Kryesuesi - Kanë ardhur disa kërkesa nga qytetarët për emërtimin e rrugëve, Kryesia e fshatit Ratkovc ka bërë ankesë po ashtu edhe kryesia e fshatit Dejnë dhe Xërxë, për të përmirësuar emërtimin e disa rrugëve. Nëse ju pajtoheni këtë e kishim lënë si pikë e fundit të rendit.

Bahtjar Hoti - Sa i përket çështjes së emërtimit të rrugëve ,në fshatin Ratkovc është bërë një manipulim me qytetarë. Janë disa njerëz që vetë kanë qenë pjesëmarrës në kryesin e fshatit edhe në mandatin e kaluar i kanë propozuar ato emra, dhe tash në momentin kur është identifikuar lista me emra që ka një ndryshim shumë të vogël dhe ata tash në emër të pakënaqësive, dhe secili dëshiron të nxjerrë emrin e anëtarit të familjarëve të vetë, dhe nëse puna e komisionit dhe e Kuvendit kalon në zbehje për shkak të një grupi manipulantesh mendojë se nuk është në rregull. Komisioni e ka kryer punën e vetë dhe kuvendi ka miratuar punën e komisionit dhe nuk ka nevojë të bëhet kurrfarë ndryshimi.

Rasim Fazliu - Propozoj që këto kërkesa që i kanë bërë kryesitë e fshatrave t'i drejtohen Komisionit për emërtimin rrugëve dhe ai ti trajtojë dhe shqyrtojë këto tema dhe të vijë me propozime konkrete para Kuvendit dhe nëse ne e shohim të arsyeshme që diçka nuk ka shkuar mirë atëherë ne si Kuvend do të marrim vendime.

Nahit Elshani- Nuk mundemi prapë në komision me e dërgu problemin, e tha Bahtjari që janë bërë manipulime por, unë vetëm një shembull do ju tregoj, në Ratkovc janë dy vëllezër që kanë vdekur pas lufte dhe që të dytë janë të emërtuar nëpër rrugë. Pra nuk është mirë kjo sepse të gjithë kemi prind dhe familjarë që na kanë vdekur dhe tash secilit ti emërtojmë rrugë, kjo nuk është aspak në rregull. Kërkesat i janë dhënuar Kryetarit dhe Kryesuesit, dhe nuk ka shumë mos pajtime, janë vetëm tre fshatra që kanë pasur pakënaqësi për disa rrugë.

Bahtjar Hoti- Edhe ato dy emrat e atyre dy vëllezërve janë propozim dhe miratim i kryesisë së fshatit, por unë mendojë se këtë manipulime e ka bërë kryesia e LDK në Ratkovc dhe ju kisha lutur që të mos manipuloni. Ato emra janë të kryesisë së fshatit mandatin e kaluar që janë propozuar dhe ne nuk kemi bërë ndryshim, a jeni që të kryhen punët institucionalisht apo të respektohen grupe të ndryshme që emocionalisht i shohin gjërat, nuk e di listën e miratim të kryesisë së fshatit në mandatin të kaluar a është i përfshirë mësuesi Nezirë Hoti dhe me këtë gabim edhe unë pajtohem sepse është një mësues që ka dhënë kontribut në fshatë.

Flori Boshnjku - Pikërisht kur është miratuar kjo listë ti kryesues ke qenë me këmbëngulje që kjo listë të miratohet. Në fshatin Fortesë në natën e fundit janë ndërruar emërtimet e rrugëve dhe nuk është pyetur kryesia e fshatit fare, ditën kur është miratuar ky vendim Kadirët të fshatit Fortesë komplet kanë qenë këtu, dhe nëse ne tash e ndryshojmë këtë vendim, pas një jave vijnë banorët e fshatit Fortesë dhe do të kërkojnë të ndryshohen rrugët dhe mundë të vinë edhe banorë nga fshatra tjerë.

Nahit Elshani - Nëse një kërkesë i drejtohet Kuvendit atëherë kjo kërkesë duhet të trajtohet dhe ne do të marrim vendim se a do ti marrim parasysh kërkesat e qytetarëve apo jo.

Fatmir Iska - Dua të qartësojë si pjesë që kam qenë në komisionin e kaluar dhe në komisionin aktual, unë nuk i njoh emrat e të gjithë banorët e komunës së Rahovecit, kjo ishte sa i përket dy emrave të atyre dy vëllezërve që janë emërtuar ato dy rrugë, propozoj që të vihet si pikë shtesë e rendit të ditës dhe mos të humbim kohë.

Kryetari i komunës - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Tek unë kanë ardhë nga 2-3 vetë nga fshatra të ndryshme të cilët i kam drejtuar tek komisioni, sepse unë nuk kam qenë pjesë komisionit dhe nuk i di detajet, dhe është shumë normale që një komision i caktuar që merë detyrën të merret me atë çështje. Por mos harroni të gjitha komisionet që merren me çfarëdo çështje, për punën e tyre vendos Kuvendi, dhe nëse dëshironi që kjo të futet në rend të ditës apo jo, ju do të vendosni. Pra, le ta dinë qytetarët cilat janë normat dhe rregullat e demokracisë, por ata që janë në shumicë vendosin, a kanë vendosë mirë ose keq, ata vetë le të mendojnë. Kryesuesi e lexoi një listë me emra, unë nuk i kam takuar këtë persona, mirëpo edhe mbase të miratohet lista, nëse vije ndonjë plotësim, ndryshim ose propozim që është bërë ndonjë lëshim ose gabim, ne e kemi për obligim që të përmisojmë, është humane që t'ju jepen të gjithëve meritat që i kanë.

Kadri Dellova - Ju kisha lutë që të mos lëshohemi në kësi pika të rendit të ditës, sepse ne kemi aprovuar një listë me emërtime të

pru Krusha, Ratkovci etj, besoj se nuk është e mirë kjo. Plotësisht e përkrahi mendimin e Rasim Fazliut dhe e falenderoj Kryetarit të Komunës, sepse me të vërtetë në asnjë moment nuk është përzier në emërtimin rrugëve dhe kjo është krenari.

Kryesuesi – Kërkesat i janë dërguar Kuvendit komunal e jo komisionit. Unë jam i obliguar t'i prezantojë para juve dhe ju jeni ata që vendosni se a doni të futni në rendin e ditës apo jo.

Luljeta Kadiri - Në këtë rast nuk duhet të hyjë në diskutim se a do të votohen vetëm kërkesat e fshatrave Ratkovcë dhe Dejnë, a do të shqyrtohet edhe kërkesa që është bërë pikërisht atë ditë, kur na vije materiali me një vendim dhe mbas 4 ditëve vjen vendim krejt tjetër. Ne e kemi bërë një kërkesë, është protokolluar në administratë, me arsyetimin e lagjes së fshatit Fortesë dhe ne dëshirojmë që edhe ajo kërkesë të shqyrtohet.

Nënkryetari - Këtu para juve edhe sot edhe atë ditë e kam thanë se ky komision i cili ka punuar, është formuar në maj ose prill 2014, publikisht e kam falënderuar komisionin e mëparshëm dhe e falënderoj edhe tash për punën që e kanë bërë, sepse ata 80% të punës e kanë kryer deri në momentin e formimit të komisionit të ri asnjë ankesë nga asnjë lokalitet nuk ka ardhur, e vetmja ka qenë Krusha që asnjë rrugë nuk ka qenë e emërtuar, por me punën dhe ndihmën e bashkëfshatarëve të Krushës arritëm me finalizim. Po ashtu edhe në disa fshatra të tjerë që kanë qenë disa rrugë të pa emëruara edhe ato janë kryer. Ka momente të ndryshimit por jo me vullnetin dhe me kërkesën e komisionit por për shkak të instruksioneve që i kemi marrë nga Agjensioni Kadastral i Kosovës doemos komisioni është dashur t'i eliminojë disa emra që kanë qenë në kundërshtim me rekomandimet e Agjensionit. Edhe diçka, në momentin që është aprovuar nga Kuvendi, komisionit i pushon mandati. Unë ju garantoj, ja ku janë edhe anëtarët e komisionit se komisioni nuk ka lëvizë asnjë presje nga propozimet e mëhershme, vetëm në momentet kur është dashur doemos t'i zëvendësoj pra vetëm aty ku kemi qenë të detyruar.

Selim Duraku - Kemi pas kritere që i kemi bërë ato ndryshime, në seancën e fundit kur është aprovuar lista me emra ka pas disa propozime dhe kryesuesi e ceku se janë marrë parasysh ato propozime. Mirë është që kërkesat e qytetarëve të respektohen por nuk e di se sa mundemi tash në Kuvend pa material të ndryshojmë këto kode, është mirë që këto përmasime ti bëjë komisioni.

Kryesuesi - Unë edhe për komisionin e parë kam pas vërejtje edhe për këtë nuk ju kam falënderuar fare për punën e bërë, sepse kriterin bazë nuk e keni përfill fare. Nuk mundet të bëhet asnjë emërtim i një rruge nëse nuk i shkruash së paku dy reshta për atë person, kush ka qenë dhe cili është kontributi i tij që ne duhet ta qesim emrin e tij të një rruge, Unë jam i detyruar që ta qesë në votim kush është që sot të trajtohet kjo çështje? Konstatoj se unanimisht është vendosur nuk hynë në rend dite kjo çështje.

Azbi Gashi - Unë kërkoj që të na jep një sqarim drejtori i Drejtorisë për financa Lulëzim Sylejmani për debatin që është bërë nëpër media për deklaratën e tij.

Fatmir Iska - Lidhur me rendin e ditës neve na erdh një material nga fshati Babovc.

Kryesuesi - Ky material duhet të dërgohet në ekzekutiv sepse ata nuk ja kanë adresuar Kuvendit.

Bahtjar Hoti - Në kohë dimri ky fshat ballafaqohet me vdekje të një fëmije për shkak të pamundësive të dërgimit tek mjeku nga rrugët që janë të pakalueshme, dhe një lokalitet, një fshat nuk ka mundësi qarkullimi dhe mua më janë drejtuar drejtpërsëdrejt në shtëpi me këtë kërkesë.

Kryesuesi - E qesë në aprovim rendin e ditës: Me një kundër dhe 29 pro është aprovuar rendi i ditës,

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Rukije Krasniqi - Kam dërguar një email lidhur me diskutimin dhe ju kisha lutur që tekstin e diskutimit të mos e shkurtoni.

Kryesuesi - Kush është për aprovimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar me vërejtje: në mënyrë unanime konstatohet që është aprovuar procesverbali i mbledhjes së kaluar.

2. Aprovimi i tejkallimit të të hyrave vetanake.

Lulzim Sylejmani, Drejtori i Financave - Është hera e parë që në Kuvendin komunal të ndodhë tejkallimi i të hyrave dhe jemi të obliguar që sot të dërgojmë vendimin e Kuvendit për alokimin e mjeteve në projekte përkatëse. Do ju lexoj disa pozicione se ku kemi tejkallim të të hyrave, në planifikimin e të hyrave nga gjobat e trafikut, në planifikimin e gjobave të trafikut dhe të gjykatave që ekzekutohen nga gjykatat. Tejkallim kemi nga të hyrat nga qiratë e objekteve në shfrytëzim, po ashtu kemi nga të hyrat e taksave të biznesit planifikimi ka qenë 80.000 € ndërsa realizimi është 106,349.67 €. Tejkallim kemi edhe tek tatimi në pronë ku planifikimi ka qenë 220.000 € ndërsa realizimi është 301,697.93 €. Vlera totale është 67,539.62 € ose në përqindje tejkallim kemi 107.11 %, nëse e bëjmë një krahasim me vitin 2013 që ka qenë 88.67%.

Selim Duraku - Tejkallimi i të hyrave vetanake ka qenë 950.000 € ndërsa realizimi i të hyrave vetanake për këtë periudhë është 1,117,539.62 € por në diferencë këtu po mungojnë 100.000 €.

Afrim Limani - Uroj që edhe në të ardhmen të kemi kesi realizime të të ardhurave sepse është në të mirën e komunës, por dua të potencoj se kjo nuk është hera e parë që kemi një tejkallim të të hyrave sepse ka pas tejkallim të të hyrave edhe në periudha tjera. Ka qenë mirë që të kemi edhe një raport të realizimit të të hyrave pra listën e projekteve kapitale që me pas mundësi edhe ne delegatë me pa mundësinë e alokimit të të hyrave.

Fatmir Iska - Është për tu përsëritur ky tejkallim i buxhetit. Tek bujqësia kodi 89743 - participimi me projekt bashkëfinansim kemi 10.000 € prej 20.000 € dhe sipas mendimit tim është vlerë shumë e madhe prej 67.000 € nga vlera totale, dhe kjo shumë le të bëhet 10.000 € këtë e propozoj, dhe 10.000 € të mbetura të shkojnë në mbështetje të prodhuesve bujqësorë 5.000 €, dhe 5.000 € të tjera në mbështetje të ekonomive familjare dhe bizneseve të vogla dhe të mesme.

Kryetari - Fatmirë Faleminderit për propozimin, por ne kemi menduar për disa projekte që janë më kapitale si sistemi i ujitjes që janë më të kushtueshme dhe për atë arsyeje kemi bartë një shumë të mjeteve, po ashtu me bashkëfinansim është edhe ndërtimi i serave. Plotësisht pajtohem me ty, por ne nuk kemi mundësi ma tepër kjo është ajo që kemi mundur të bëjmë.

Fatmir Isak - Unë e kam kuptuar se projektet i bënë komuna dhe dorëzohen tek donatorët ose ministritë përkatëse, pra unë në këtë formë e kam kuptuar.

Lulzim Sylejmani - Ju kërkoj falje për një gabim teknik tek vlera e përgjithshme është 1,117,539.62€, ndërsa vlera që e kam paraqitë në projekte është e saktë 67,539.62 €,

Florije Boshnjaku - Ky propozim që na ka ardhë për tejkallimin e të hyrave vetanake mendoj se është dashur së pari të vije një vendim që miratohet tejkallimi i të hyrave vetanake të planifikuara dhe të realizuara dhe bartja e këtyre projekteve të bëhet kur të

bëhet bartja e të hyrave vetanake nga viti 2014 në 2015, kjo të shkon ndarës dhe kur të bëhet bartja e të hyrave vetanake që kanë mbetur nga projektet e tjera me një vendim tjetër.

Lulzim Sylejmani - Një aprovim i Kuvendit duhet për pjesën që e kemi tejkalua sepse këto mjete nuk mundën të shfrytëzohen më për buxhet, sepse ka kaluar viti por vetëm duhet të bëhet një aprovim se ku duhet mu vendosë për punë që të bëhet në bartje me një vendim total, ky është propozim i yni.

Kryesuesi - E ka plotësisht të drejtë Florijs duhet të bihet një vendim për bartjen e pastaj bartjen si e bënë është diçka tjetër, sepse ti kështu nuk mundesh ta dërgon në Prishtinë, sot e aprovim sepse jemi me vonesë por herëve tjera të jetë propozim vendim.

Rukije Krasniqi - Tek kodi 39745 mbështetja e prodhuesve bujqësorë a specifikohet vetëm për blegtorë, shpeztari dhe bletari apo të përgjithshëm duke përfshirë edhe kulturat tjera bujqësore, mendoj se duhet të ritet ky kod së paku edhe 5.000 €.

Lulzim Sylejmani - Prej këtij kodi vitin e kaluar është bërë pagesa e plehut që e kemi bërë shpërndarjen në gjithë komunën e Rahovecit, por nuk do të thotë që në këtë vit nuk do të ketë edhe blegtoria ose shpeztaria.

Afrim Limani - Desha të japë një sqarim në lidhje me bartjen e të hyrave vetanake, kjo është e rregulluar me ligjin e financave publike dhe përgjegjësi dhe me një njësi buxhetore si komuna jonë që ka bërë tejkalimin të hyrave vetanake atëherë nga Drejtoria e financave kërkohet që të jep propozim për kuvendin i cili nxjerr vendimin dhe ai vendim shkon në Ministrinë e financave.

Kryesuesi - E qesë në votim: Konstatohet në mënyrë unanime është aprovuar.

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim Vendimit për shpalljen e zonës së interesit publik për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Krushë të Madhe. Edhe kjo pikë e rendit të ditës është shqyrtuar dhe trajtuar në KPF dhe aty është parë se komuna ka një projekt sa i përket këtij impianti, dhe ai projekt sa kam kuptuar unë i ka kushtuar komunës diku rreth 17.000 €. Por ai projekt më tepër është një projekt ideor dhe nuk i plotëson kriteret as kushtet për një implant.

Kryetari - Problemi i ujërave të zeza është aktual në Kosovë dhe ka me qenë edhe një kohë të gjatë, unë personalisht kam kërkuar prej drejtorit që të hulumtohet pika ma e poshtme që është në komunën tonë dhe që është pronë publike dhe të shpallet interes i përgjithshëm në mënyrë që të merret ajo tokë dhe të ketë një destinacion të caktuar, sepse siç e shihni për çdo ditë parcelat janë të rrezikuara prej kontrabandistëve. Drejtori e ka gjet vendin dhe është sipërfaqja e caktuar dhe të gjitha fshatrat mundën të përfshihen dhe të ndërtohet, sepse ka hapësirë të mjaftueshme që ti akumulojë të gjitha ujërat e zeza dhe nuk do të ketë nevojë që të bëhen copëzime dhe të ndahet një impiantet në disa lokacione.

Kujtim Popaj - Pra bëhet fjalë për një akt për shpalljen e interesit të përgjithshëm publikë për ngritjen e impiantit i cili ka të bëjë me trajtimin e ujërave të zeza në zonën kadastrale Krushë e Madhe, dhe pas propozimit të kryetarit Drejtoria për gjeodezi dhe pronë i ka bërë gjitha përgatitjet për nxjerrjen e këtij akti. Është një zonë në kufi me Drinin e bardhë dhe që është larg vendbanimit të Krushës së Madhe me një sipërfaqe 4 hektarë dhe e mbulon për ngritjen e këtij impianti. Këto prona janë të lira dhe nuk janë duke u shfrytëzuar për asgjë, po ashtu në KPF është diskutuar se ekziston një projekt, ne e kemi shikuar dhe shqyrtuar me drejtorin e urbanizmit dhe mendojmë se nuk është projekti aq ideor. Nëse mendojmë së është interes i përgjithshëm ngritja e atij impianti atëherë në të ardhmen do të shpallet një tender dhe do të bëhet një projekt i natyrshëm dhe që të realizohet ai, këto parcela i ndanë lumi i Celinës dhe i Krushës së Madhe dhe e ka derdhjen në Drinin e bardhë.

Kadri Dellova - Si përfaqësues i fshatit e përkrahi fuqishëm idenë e Kryetarit të komunës se ka ardhë koha e fundit të mbrohet pronat publike. Më vjen mirë që jo vetëm Krusha por edhe fshatrat për rreth që do të kyçen në këtë implant për filtrimin e ujërave të zeza. Ne para 12 vite kemi ndërtuar rrjetin e kanalizimit atmosferik me participimin 50 % të banorëve në kohën kur kemi dalë nga lufta me shumë të vrarë dhe të zhdukur, por për fat të keq që 12 vite kemi ndërruar gjitha pushtetet që nga koha e Esat Haxhijahës e deri më sot askush nuk është përgjigj për mirëmbajtjen e kanalizimeve. Sa i përket parcelës unë e falënderoj drejtorin e Gjeodezisë se më të vërtetë pe bënë një punë të shkëlqyer, por me material që na kanë servuar unë shoh vetëm një hartë të thjeshtë. Ne i kemi këtu mjetet teknike e kemi edhe projektorin dhe le të prezantohet në projektorë. Mendoj se është dashur të mbahet edhe një debat publik, dhe sa e di unë në këtë pronë janë 2 superacione dhe ka disa sera dhe një fermë e pulave dhe kishte qenë mirë të sqarohet kjo punë e tokës.

Luljeta Kadiri - Në kopjen e planit kemi vetëm numra po ashtu edhe në mbledhjet e kaluara i kemi pasur njëjtë. Kam potencuar se ne këshilltarët me kode nuk i dimë parcelat, kështu që gjatë përpilimit të kopjeve sadopak vetëm një aneks të jepet emërimin atëherë do ta kishim një orientim.

Fatmir Iska - Këtu kemi të bëjmë me një vendim të shpalljes së zonës së veçantë të interesit publikë dhe komuna e dinë mirë se ky është një projekt gjigant dhe komuna nuk ka mjete për të ndërtuar këtë, mirëpo qëllimi është që të mbrohet kjo parcelë që të mos merret nga dikush tjetër. Dua të lidhem edhe me një projekt që është bërë nga një kompani gjermane për ujërat e zeza, ndërsa drejtori i kadastrës na thotë se ai së bashku me drejtorin e urbanizmit e kanë parë këtë projekt dhe kanë konstatuar që ky projekt nuk i plotëson kushtet, sepse nuk është bërë ashtu si duhet, ndërsa një projekt të tillë e kanë projektuar inxhinierët e ndërtimtarisë dhe të ujit nga Gjermania së bashku me inxhinierët e komunës, dhe së bashku janë pajtuar se ky projekt është një projekt i mirë dhe i plotëson kushtet dhe kriteret për me vazhduar ma tutje. Atëherë si mundet që të njëjtit njerëz me konstatu se ky projekt nuk i plotëson kushtet, ndërsa kolegu Dellova thotë se në këto prona ka sera, ferma etj, Do të lexojë nenin 2 të këtij vendimi i cili thotë? Ngastrat e cekura ma lartë nëpërmjet personit zyrtar dhe ekspertit teknik gjeometër në vendin e ngjarjes janë konstatuar si të lira dhe nuk shfrytëzohen për kurrfarë qëllimi. Tani cila është e vërteta atë që tha drejtori apo kolegu Dellova. Pajtohem që të kemi një projektor që ti shohim këto prona përmes fotove ortografike, përndryshe flasë në emër të grupit të këshilltarëve të AAK dhe ne e përkrahim këtë vendim.

Kryetari - Çështja është shumë delikate por shumë e rëndësishme dhe dëshira është e gjithëve që ne ta realizojmë sa ma shpejtë këtë, por kostoja e këtyre projekteve është shumë e madhe, pra ne sot fjalën e kemi vetëm për prona. Fatmiri shumë mirë e ka kuptuar dhe ju ka sqaruar që pika ma e ulët në komunën e Rahovecit është ajo në mesë Krushës dhe Celinës dhe unë kam menduar për gjithë ato fshatra që janë aty të përfshihen, të gjitha ato dokumente që janë për këtë çështje do ti marrim në rishqyrtim sepse nuk jam i interesuar të shpenzoj mjete për një çështje që është kryer në të kaluarën.

Sinan Ejupi - Kryetari i tha të gjitha nuk kemi çka të komplikojmë propozimi është për tu përshëndetur dhe nëse është bërë ndonjë studim është i mirëseardhur mund të shfrytëzohet, ne e dimë se kjo nuk do të zbatohet menjëherë projekti i impiantit sepse kjo kushton me miliona.

Flori Boshnjaku - Ajo që është prioritet është se ne sot a dëshirojmë të marrim vendim për të shpallur zonë në interes të përgjithshëm, pajtohem me profesorin kur tha se është një çështje e ndjeshme dhe pajtohem që kjo pronë të del në debat publik që të mos kemi ma vonë probleme.

Selim Duraku - Unë nuk pajtohem me kolegun Sinan dhe disa tjerë, unë kam qenë fizikisht tek vendi i ngjarjes dhe desha të ndërlidhem me pikën numër 2 ku janë cekë lartësia nëpërmjet personit zyrtarë ekspertit teknik gjeometrit në vendin e ngjarjes. Vendi i ngjarjes nuk korensponon kurrë me numrat kadastral që janë këtu, pra këtu afër 50 % është e marrë prej Drinit të bardhë, unë nuk e di ku i ka parë ai 4 hektarë hapësirë në atë pjesë, sa i përket vendimit edhe ne grupi i LDK e përkrahim.

Kryesuesi - Problemi është që të mbrojmë këtë pronë sepse ne nuk do ta ndërtojmë tash ndoshta shkojnë edhe 5 vite tjera dhe nuk do të mundemi ta ndërtojmë.

Rasim Fazliu - Mbas sqarimit që e dha kryetari dhe drejtori ishin mendoj se nuk kemi pas nevojë fare të hapim debat. Mendoj se nuk kemi çka të bisedojmë, ne vetëm po dëshirojmë ti mbrojmë këto prona dhe ti tregojmë destinimin për çka janë dhe asgjë ma tepër, neve na ka mbetur vetëm të tregojmë se a jemi për të ruajtur tokat apo jo.

Kryesuesi - E qesë në votim: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar kjo pikë e rendit të ditës.

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim Vendimit për shpalljen e interesit publik për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale. Edhe ky propozim vendim është shqyrtuar në KPF, është një pronë në mesë të Hoçës së madhe dhe Zoqishtit. Ka të interesuar për me marrë për të ndërtuar objekte hoteliere, po ashtu interesi i komunës është që atë pronë ta shfrytëzojë për zhvillim ekonomik të komunës, kështu që me Ligjin mbi dhënien e pronës komunale në shfrytëzim Kuvendi i komunës merr vendim për shpalljen të interesit të përgjithshëm pastaj procedurat për dhënien në shfrytëzim për dhënien e pronës komunale janë përmes ankandit publik. Ankandi publik për dhënien e pronës në kohë afatgjatë është minimum 45 ditë dhe pastaj procedurat i udhëheq komisioni që ne e kemi formuar, në fund pas përcaktimit të ofertave më të mira prapë vendimin e mer Kuvendi komunal për dhënien në shfrytëzim, kemi të bëjmë dhënien e pronë mbi 15 vite, pra një shfrytëzim afatgjatë.

Kujtim Popaj - Kemi të bëjmë me dy parcela në zonën kadastrale Hoçë e Madhe me sipërfaqe 2 hektarësh, është tokë e pa shfrytëzueshme është tokë që shfrytëzohet vetëm për kulloso, pra nuk ushtrohet asnjë veprimtari tjetër. Ne kemi konstatuar që është në interes të përgjithshëm ngritja e një veprimtarie hoteliere në këtë vend, përndryshe nuk është e përfshirë në zonën kadastrale të Hoçës së Madhe, kështu që pas aprovimit nga ana e juaj e këtij vendimi mbetet që komisioni i formuar nga ana e Kuvendit sipas Ligjit për dhënien në shfrytëzim të pronave duhet ti udhëheqë procedurat tjera. Ne kemi konstatuar që periudha të jetë 40 vjeçare, përndryshe është e drejta e juaj të diskutoni dhe ta aprovoni dhe nëse mendoni se duhet të jepet një afat më i gjatë atëherë ju jeni ata që vendosni.

Selim Duraku - Nëse i jepet investitorit për 40 vite të bëjë një investim unë mendoj se do të jetë një investim shumë i vogël sepse afati kohor për dhënie në shfrytëzim është shumë i vogël, unë kisha propozuar që të rritet nga 40 vite në 60 vite.

Ejup Kabashi - Këtë vendim që ka ardhur e mbështesë vetëm në pikën që të mbrohet si zonë e interesit, por për mua është e pa pranueshme që të jepet për zhvillimin e veprimtarisë hoteliere. A thua komuna jonë ka nevojë për ma shumë hotelieri kur e dimë se komuna në mandatin e kaluar i ka dhanë dy parcela për këtë veprimtari dhe me zotimin për investime marramendëse dhe sot janë shndërruar në parkingje për autobusë. Kërkoj që kjo as të mos figurojë për veprimtari për hoteliere, unë do të votojë kundër nëse shkohet me destinacion të caktuar për zhvillimin e hotelierisë.

Kryesuesi - Mos predikoni, në atë pjesë ka sallone dasmash dhe nuk ka hotele, sepse hoteli dallohet prej sallon dasmash. Në komunën e Rahovecit e kemi një hotel dhe ai nuk është funksional, ne jemi të interesuar që pronat që janë në bjeshkë mos ti japim për gurëthyes por për veprimtari të zhvillimit ekonomik.

Sinan Ejupi - Po ashtu edhe unë e mbështesë kolegun Ejup sepse destinimi është bërë për hotelieri ndërsa nuk pajtohem me kryesuesin kur thotë se ne do të bëjmë zhvillim ekonomik nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve hoteliere, sepse i gjithë vendi ynë bazohet në ndërmarrje shërbyese dhe jo në prodhim neve. Na duhet prodhimi për të shkuar përpara, unë jam pro që të mbrohet prona dhe të destinohet për zhvillim ekonomik, por jo në këtë formë si na ka ardhur tash. Shpesh herë në komisionet që formohen na ndodhë që të kemi vetëm njerëz me kapacitete teorike, është mirë kur të formohen komisionet të shikohet pak sepse e gjithë intelijenca e komunës së Rahovecit nuk është e shkrirë në këtë asamble.

Lirih Berisha - Të gjithë jemi për miratimin e këtij vendimi mirëpo vetëm të hiqet veprimtaria hoteliere dhe të mos destinohet për hotelieri.

Fatmir Iska - Flas në emër të këshilltarëve të AAK dhe ne jemi që të hiqet destinimi i caktuar për hotelieri, dhe në KPF jemi marrë veshë që në komision për vlerësimin e ofertave të jetë edhe një anëtar nga opozita, dhe ne si opozitë nuk do ta përkrahim asnjë vendim të këtij lloji deri sa të mos jetë ndonjë anëtar nga opozita në këtë komision në mënyrë që komisioni të jetë ma transparentë.

Kryesuesi - Kemi një propozim që të mos përmendet veprimtaria hoteliere, por vetëm të destinohet për zhvillim ekonomik, e qesë në votim: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar me propozimin që të mos përmendet destinimi. Po ashtu kemi edhe një propozim që të jetë ma shumë se 40 vite sepse askush nuk do të të investojë për një afat 40 vjeçar, edhe unë pajtohem që kjo të rritet.

Kryetari - Plotësisht pajtohem që të mos predikohet veprimtaria, dhe po ashtu unë si kryetar komune pajtohem që një anëtar në komision të jetë nga opozita.

Nënkryetari - Tek çështja e afateve të dhënies së pronës në shfrytëzim ligji e specifikon afatshkurtër 1-15 afatgjatë 15-99 vite, mirëpo është një rregull që kemi hasur që i sugjerohet komunave që të mos tejkalojë 40 vite me të drejtë vazhdimi për investitorin.

Kryesuesi - Problemi është se nëse ka afat më të gjatë investitorë do të ketë ma tepër dhe do të ketë investime ma të mëdha, sepse askush nuk do të vjen ta ndërtojë një fabrikë me kapacitete të mëdha me afat 40 vite. E qesë në votim. Kush është për propozimin që të rritet në 99 vite: 12 për, kundra 14, pra mbetet ashtu si është për 40 vite afat.

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim Vendimit për autorizimin e kryetarit për nënshkrimin e Marrëveshjes për mbulimin e shërbimeve në shërbimet e veprimtarisë edhe kjo pikë e rendit të ditës ka kaluar në KPF dhe është aprovuar që të vijë në këtë

formë. Përndryshe komitetit ju ka ofruar si marrëveshje mes kryetarit dhe Bashkësisë Islame në Rahovec, duke përjashtuar bashkësitë tjera fetare dhe Komiteti ka kërkuar që kjo të bëhet në formë të vendimit ku do të autorizohet kryetari që me të gjitha bashkësitë fetare të lidhë marrëveshje sa i përket kompensimit të shpenzimeve të varrimit.

Rasim fazliu - Është një iniciativë shumë e qëlluar që është marrë nga ana e kryetarit të komunës për mbulimin shpenzimeve të varrimit. Ne edhen në KPF kemi diskutuar mirëpo desha edhe sot të cekim, tek pika 4 kisha propozuar që të bëhet një ndryshim, në qofse edhe ju e shihni të arsyeshme të ndryshohet me këtë tekst: Propozoj që banorët e komunës së Rahovecit mbi bazën e marrëveshjes do të marrin të gjitha shërbimet e varrimit në bazë të procedurës dhe kushteve të cilat do të precizohen në marrëveshjen të cilën e lidh kryetari i komunës me bashkësitë fetare, besoj se gjithë kolegë do të mbështesin këtë propozim vendim dhe ta bëjmë një shërbim të mirë për qytetarët.

Fatmir Iska - Sa i përket këtij vendimi është i mirë, por unë në KPF nuk e kam përkrah marrëveshjen që na është servuar prej kryetarit të komunës ose ma saktësisht prej drejtorit të shërbimeve publike. Drejtori ka cekur se kjo marrëveshje është marrë si formë prej komunave tjera dhe është bërë kjo marrëveshje që duhet ta lidh kryetari me Bashkësinë islame, unë pajtohem me këtë por jo në këtë formë. Në marrëveshje është specifikuar se kryetari i komunës lidhë me bashkësinë islame dhe përcaktohet shuma që do të derdhet në xhirollogari të të saj, ndërsa bashkësia islame merr përsipër vetëm shpenzimet e varrimit. Dua të them se komuna e Rahovecit është specifike sa i përket kësaj për arsye se ka, de facto ekziston edhe një bashkësi tjetër që i kryen këto shërbime. Kam dy vendime nuk e di se cilin vendim me e marrë të drejtë, vendimin e parë ose vendimin e dytë që na është servuar. Një vendim cekë në pikën 4 se banorët e komunës së Rahovecit që nuk janë të besimit islam do të subvencionohen individualisht, ndërsa vendimi tjetër thotë se banorët e komunës së Rahovecit do të kompensohen pasi që dëshmojnë vdekjen në bazë të vërtetimit të vdekjes ose certifikatës. Ne si Kuvend jemi para aktit të kryer sepse një marrëveshje po zbatohet në Komunën tonë. Nuk janë konsultuar të gjithë prijësit fetarë sepse në komunë kemi edhe prijësit e tarikatit. Për të lidhur një marrëveshje të tillë i nderuari kryetar është dashur ju të bashkëpunoni me këta prijës fetarë, të konsultoheni me ta dhe si do të muret kjo formë e vendimit Që të merret një vendim i përbashkët, unë jam dakord që shuma 200 € ti jepet familjarëve për shpenzime të varrimit.

Kryesuesi - Është e vërtetë që kemi debatuar në KPF dhe kemi thanë se ky vendim do të jetë në fuqi për 1 vit dhe gjatë këtij viti Drejtoria e shërbimeve publike do ta përgatit një rregullore që do ta rregullojë këtë çështje dhe për atë arsye kemi marrë një vendim të kësaj forme.

Nënkryetari - Kuvendi është i vetmi organ i autorizuar dhe legjitim që një propozim vendim të tillë ose të aprovoni, ta ndryshojë ose ta hudhë. Nuk rregullohet një çështje madhore që do të merr Kuvendi si vendim marrës me një marrëveshje, pra çdo marrëveshjeje duhet t'i paraprijë vendimi i cili do të miratohet nga Kuvendi. Esenca është ndihma e qytetarëve të komunës së Rahovecit në rastet mortore, pra ne kemi menduar një solucion që të mos merret me probleme familjare, por të ketë një shërbim të caktuar për momente të caktuara. Në Kosovë ende nuk është në fuqi Ligji për bashkësitë fetare, sepse ende nuk janë subjektet juridike të pranuar me një ligj të veçantë, për atë arsye ne po nxjerrim një vendim të përkohshëm 1 vjeçar. E përmendët se marrëveshja është duke u zbatuar nga Bashkësia islame në Rahovec. Kjo ndoshta është e vërtetë, por kryetari nuk lidh me askënd marrëveshje pa vendimin e Kuvendit. Unë plotësisht pajtohem që pika 4 ka të bëjë me atë që ka qenë në vendimin e parë që banorët e komunitetit jo islam të kompensohen në mënyrë individuale dhe plotësisht pajtohem për ndryshim dhe të jetë gjenerale,

Afrim Limani - Unë e përshëndesë këtë iniciativë të kryetarit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit është gjest i mirë dhe është mirëpritur mjaft mirë nga qytetarët e komunës së Rahovecit, Unë para vetit kam një vendim dhe me pikën e 4 të këtij vendimi nuk pajtohem dhe duhet të jetë një formë unike për të gjitha besimet. Po ashtu më intereson se nga cili kod i buxhetit do të paguhet këto, nëse paguhet nga subvencionet unë ju them kryetar se shuma e subvencioneve për mbulimin e këtyre shpenzimeve është e pa mjaftueshme. Propozimi im është që të bëhet pagesa në xhirollogarinë e familjarëve në rastet e vdekjes.

Kryetari - Ne kemi shkuar në bazë të disa komunave dhe i kemi marrë si mostër, unë e kam parasysh atë që tha Fatmiri dhe shumë mirë e njoh strukturën e komunës së Rahovecit, por vendimin është 1 vjeçar me qëllim që ta presim Ligjin për bashkësitë fetare. Jam i pajtimt që nëse ligji parasheh ndarje tjera unë pajtohem plotësisht, jam që ti fusim në marrëveshje dhe me secilën të bëjmë marrëveshje veç e veç dhe pastaj ata të kryejnë procedurat që i kanë për obligim. Mendoj se individualisht është ma problem por prapë ju jeni ata që vendosni, sa i përket shumës së mjeteve e dimë se nuk janë të mjaftueshme por kemi menduar që me rishikim t'i shtojmë.

Flori Boshnjaku - Nuk e kam diçka të qartë tek neni 3 dhe 4, në nenin 4 thuhet: banorët e komunës së Rahovecit do të kompensohen pasi që do të dëshmojnë vdekjen në bazë të vërtetimit të vdekjes nga mjeku dhe certifikatën e vdekjes pranë Drejtorisë komunale për shëndetësi dhe punë sociale. Banorët nuk kompensohen, ne po bijmë në kundërshtim me atë që po diskutojmë. Unë isha pajtuar me propozimin e Fatmirit që këto mjete ti lëshohen familjarëve të të vdekurit.

Kryesuesi - Kryesia e Bashkësisë islame është takuar me mua me kërkesë të tyre, ata më kanë thanë se ne e kemi Këshillin e Bashkësisë ku të gjithë hoxhallarët marrin pjesë aty si dhe nëpër fshatra edhe përmes lagjeve të Rahovecit. Po ashtu edhe teqetë me cilin hoxhë kanë marrëveshje dhe bashkëpunim ata dhe përmes atij do i kryen të gjitha procedurat, pra ata merren vesh në mes vedit se si do ti organizojnë punët rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit.

Xhihad Vuqetërna - Unë këtë propozim vendim e përshëndes dhe e përkrahi në të gjitha pikat dhe besoj se nuk ka ndonjë pengesë ose ndonjë arsye që të krijojmë ndonjë tendencë mosmarrëveshje të çfarëdo lloji ndërmjet qytetarëve të komunës së Rahovecit. Të gjithë qytetarët e Rahovecit ritet e varrimit do t'i kryejnë sipas besimit fetarë që e kanë. Një marrëveshje me bashkësitë fetare është e mirëseardhur me afat 1 vjeçar deri sa të rregullohen me norma ligjore dhe unë i ftoj që të gjithë që të përkrahin këtë propozim vendim.

Sinan Ejupi - Unë nuk e kam të qartë tash kush do të jetë përfitues i këtyre mjeteve, familjarët e të vdekurve apo Bashkësia islame. Unë jam që të jenë përfitues familjarët e të vdekurve deri sa të hyjë në fuqi Ligji për bashkësi fetare.

Bahtjar Hoti - Hoxhallarët paguhet nga qytetarët, dhe unë kisha me propozuar që komuna të shpërblejë qytetarin që e humbë anëtarin e familjes drejtpërdrejt e jo përmes Bashkësisë islame.

Ejup Kabashi - Unë e përkrahi këtë propozim vendim aktual që e kemi para vetit dhe nuk pajtohem me disa kolegë, unë i di vështirësitë e qytetarëve të cilëve i ndodhë ndonjë fatkeqësi. Çfarë të bëjë ka këtu nëse ai boshë që ia kryen ceremoninë e varrimit

asaj familje të paguhet në Bashkësi islame ata detyrimisht e kanë që t'i tregojnë familjarëve se shpenzimet e varrimit i keni të kryera nga komuna,

Besnik Hoti - Unë e përkrahi propozim vendimin e kryetarit, mirëpo unë jam që mjetet të ndahen në xhirollogarinë e familjes e jo përmes Bashkësisë islame dhe kisha me propozuar që kjo të hidhet në votim kush është për Bashkësinë islame e kush është për xhirollogarinë familjare.

Rasim Fazliu - Shërbimet kanë me u kryer për të gjithë qytetarët e komunës së Rahovecit dhe këtu nuk ka të bëjë asgjë me kompensim, ne askujt nuk duam ti japim pare por familjarëve që i bie ndonjë rast vdekje. Ne dëshirojmë t'ia lehtësojmë atë ditë që ai të mos ketë brenga rreth varrimit dhe shërbimet t'i kryej dikush tjetër e në këtë rast Bashkësia islame. Këtu është e qartë gjithçka kryetari i komunës thotë se do të lidhë marrëveshje me gjitha bashkësitë fetare.

Kadri Dellova - E përgëzojë me të vërtet kryetarin komunës për këtë iniciativë humanitare sepse ka shumë familje që në rast të vdekjes të ndonjë anëtarit të familjes nuk mundin t'i përballojnë shpenzimet e varrimit. Ne Krushja kemi një përvojë që 16 vite me rivarrim të martirëve. Qeveria e Kosovës e ka bërë një praktikë shumë të mirë, pas momentit të rivarrimit secila familje ka ardhur në komunë, në Drejtorin e shëndetësisë me një certifikatë të vdekjes që i është lëshuar nga mjekësia ligjore dhe në bazë të asaj certifikate Qeveria e Kosovës ja ka lëshuar në xhirollogari të familjes 250 € për shpenzimet e varrimit, Unë insistoj fuqishëm që shpenzimet e varrimit të lëshohen drejtpërdrejt në xhirollogarinë e familjes.

Fatmir Iska - Sa për sqarim nëse familjarë që kanë rast vdekje nuk janë të njoftuar që komuna ofron një shumë për shpenzimet e varrimit atëherë mundë të njoftohet nga ndonjë i afërt, dhe një përgjigje për nënkryetarin kjo marrëveshje është duke u zbatuar nga 1 janari 2015,

Munib Durguti, Drejtori i Shëndetësisë – Unë mendoj se ky është një vendim shumë i përshtatshëm dhe i përshtatet gjitha kategorive dhe drejtimeve që i kemi në komunën tonë, pra këtu bëhet fjalë për shërbime gjenerale, gjatë ceremonisë së varrimit, secili është i lirë ta thërrasë kë të dojë, hoxhën ose shehun dhe të ketë orientim të lirë, në këtë drejtim ato do ti paguhet Bashkësisë islame ose shërbimit nga i cili mer aty ku nuk kemi dallime gjatë ceremonisë së varrimit. Unë propozoj që të jetë përmes Bashkësisë islame ndërsa pjesa tjetër që nuk i përket komunitetit islam ti paguhet secilit për pjesën e vetë, ndërsa unë jam kundër propozimi që u dha këtu nga disa kolegë sepse është edhe në kundërshtim me Rregulloren për subvencione, këtu kemi të bëjmë për kompensimin e të gjithë qytetarëve pa marr parasysh kategoritë socio ekonomike. Patjetër duhet të shkohet me një marrëveshje e cila i precizon qartë shërbimet gjenerale që i përshtaten gjithë qytetarëve të komunitetit islam.

Kryesuesi - Faleminderit për kontributin e dhënë, kemi propozimin parë nga Rasim Fazliu që pika 4 të ndryshohet nga ky propozim vendim. Egesë në votim. Kush është për këtë propozim: 10 pro, 12 kundër, nuk kalon propozimi i delegatit Rasim Fazliu,

Nënkryetari - Ne nuk po flasim për përmbajtjen por flasim për propozime nëse kalon njëri apo tjetri propozim atëherë përmbajtja shtjellohet, çfarëdo që të jetë forma e aprovimit nëse aprovohet vendimi që të shkohet në mënyrë individuale ne duhet ta shtojmë një konkluzion për gjitha rastet të cilat kanë ndodhur deri më tani dhe qytetarët i kanë shfrytëzuar shërbimet nga Bashkësia islame në komunë që të mos mbesin të pa mbuluara për arsye se Bashkësia islame nuk mundet dhe nuk ka mundësi ti paguaj mjetet vetë.

Luljeta Kadiri - Shumica e vdekjeve ndodhë në spital, dua ta di se kush e merr përsipër bartjen e kufomës prej spitalit deri në shtëpi, nëse i japim Bashkësisë islame këtë shumë atëherë a do të jetë ajo përgjegjëse edhe për transportin e kufomës deri në shtëpi.

Kryesuesi - Kemi edhe një propozim që nuk korrespondon me vendimin që mjetet për shërbimin e varrimit të i lëshohen në llogari të familjarëve pra kompensim individual dhe jo përmes bashkësisë islame dhe unë e qesë në votim: Me shumicë të votave konstatoj që propozimi është aprovuar që mjetet t'i derdhën familjarëve në mënyrë individuale,

Qazim Qeska - Pika e 3 e këtij vendimi që ne e kemi sot në kuvend nuk duhet të ndryshohet, çka e apostrofon me ligj, ndërsa mjetet i lëshojmë familjes dhe familja me ato para i kryen gjitha procedurat e varrimit.

Kryesuesi - Propozimi ka kaluar dhe keni vendosur që t'i lëshohet në llogarinë personale të familjes që kanë rastë vdekje, ndërsa formën e vendimit do ta rregullojmë në bazë të propozimeve që janë dhanë sot në Kuvend.

Kryetari - Ne të gjithë jemi përgjegjës sot që jemi këtu në sallë dhe ne jemi duke bërë një farë dezintegrimit klasik, flasim për bashkësi dhe tani po kalojmë në individë por prapë si të doni vendosni sepse ju jeni ata që vendosni ne vetëm kemi propozuar, por mos harroni se edhe ky propozim është 1 vjeçar sepse së shpejti hynë në fuqi Ligji për bashkësi fetare dhe ndoshta me këtë ligj do të paguhet qytetarët nga shteti drejtpërsëdrejti.

Kryesuesi - E qesë vendimin në votim me këto propozimet që kanë kaluar dhe njëri propozim i cili nuk ka kaluar dhe me një pikë të veçantë që prej 1 janarit e deri me 1 shkurtë komuna ka për obligim ndaj Bashkësisë islame t'i kompensojë për shërbimet që i ka kryer. Me 2 kundër dhe asnjë abstenim është aprovuar propozim vendimi.

6. Shqyrtimi dhe aprovimi i statutit të QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec, Na ka ardhur një kërkesë nga sindikata e QKMF nga personi Nysret Rexha, që për drejtorë të QKMF të ketë të drejtë të zgjidhet edhe ekonomisti ose juristi i diplomuar, sepse mjeku i mirë nuk do të thotë që mundë të jetë edhe menaxher i mirë, Prandaj i bëj apel kuvendarëve që të votojnë për ndryshimin e kësaj pike të nenit 17 sepse vetëm kështu mundemi të bëjmë ndryshime në këtë sektor shumë të rëndësishëm me të cilin nuk është menaxhuar ashtu siç duhet faktet flasin se në çfarë gjendje është ky institucion i komunës sonë.

Drejtori i Shëndetësisë - Ne kemi punuar në këtë draft statut dhe në koordinim me zyrën ligjore në Ministri dhe ata janë të prerë se drejtori i QKMF duhet të jetë specialist i mjekësisë familjare.

Flori Boshnjaku - Në lidhje me këtë propozim statut unë i kam pas edhe disa propozime disa janë të inkuorporuar disa jo. Tek neni 4 selia e QKMF në Rahovec është Rruga Vëllezërit Frashëri, a është kjo rrugë apo ndonjë rrugë tjetër. Tek neni 5 në mes të vulës është logoja por duhet të shënoni se cila logo se është shumë me rëndësi sepse është akt më i lartë i një institucioni. Po ashtu kam propozuar që të caktohet dita e QKMF, të jetë dita kurë ka lindur dr. Fahredin Hoti. Po ashtu mjekut të dalluar ti ndahet çdo vit çmimi Ali Sokoli. Tek neni 11 ne krenohemi me maternitetin dhe me departamentet që i ka QKMF në Rahovec mbas kujdesit primar shëndetësor është e organizuar në këtë mënyrë është departamenti i mjekësisë familjare, departamenti i administratës, barnatorja dhe materniteti këtu nuk janë të cekura duhet të cekem, barnatores i jepet shefi ndërsa departamentit të administratës nuk i lejohet sepse është departament Propozoj që secili sektor të ketë shefin e vetë. Në lidhje me zgjedhjen e drejtorit, konkursi duhet të

jetë publik dhe pas dokumentacionit që kemi shfletuar aty thotë se përparësi kanë mjeku i mjekësisë familjare, por duhet të kenë të drejtë edhe tjerët, kisha propozuar që të vihen në votim që ta dimë se çka po ndryshohet në statut.

Kadri Dellova - Tek neni 11 struktura e institucionit, ne të gjithë e dimë se në komunën e Rahovecit kemi të sëmurë nga dializa dhe këtë shërbim e kryejnë në spitalin e Prizrenit. Tash me këtë transfer që na kanë bërë me komunën e Gjakovës pse nuk është inkuorporuar edhe sektori i dializës, kur e di që në një seancë drejtori i shëndetësisë ka paraparë që në të ardhmen QKMF-ja në Rahovec të ketë repartin e dializës.

Rukije Krasniqi - Kam një pyetje rreth sektorit të ortopedisë që është në katin e 3-të, a është e mundur që ortopedia të bartet në katin përthësë.

Kryesuesi - Kemi një propozim për maternitetin, propozim tjetër është që të ndahet çmimi Ali Sokoli mjekut të dalluar, propozimi tjetër është që çdo sektorë të ketë shefat dhe të caktohet dita e QKMF-së, data e lindjes së Dr. Fahredin Hotit, për momentin njësia e dializës nuk është, jemi duke punuar në atë drejtim.

Drejtori i Shëndetësisë - Pajtohem me disa propozime por për disa besoj se nuk kemi nevojë. Kur ka të bëjë me shefat e njësisë ajo shikohet sipas mundësive buxhetore që i kemi, departamenti i administratës udhëhiqet dhe mbikëqyrët drejtpërdrejt nga drejtori, pra ata janë stafi ndihmës i QKMF, ndërsa sa i përket vulës kemi caktuar që të jetë logoja unike në nivel Kosove që është në faqen e parë të statutit, në rreth keni propozuar që të jetë Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale e që duhet me qenë QKMF, ndërsa për shërbimin dializës ju them se jemi me një proces shumë të mirë dhe besoj se deri në fund të vitit do të pajisemi me shërbimin e dializës si njësi satelite në kuadër të QKMF-së.

Kryesuesi - E qesë në votim draft statutin me propozimet e dhëna. Me 17 pro, 7 kundër dhe asnjë abstenim është aprovuar Statuti i QKMF.

7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Rregullores për taksa, tarifa, gjoba dhe ngarkesa. Edhe kjo pikë e rendit të ditës është trajtuar në mbledhjen e dhjetorit vitit të kaluar dhe ka marrë dritën e gjelbër që të shkojë në debat publik dhe është mbajtur debati me qytetarë, të gjitha propozimet që janë propozuar besoj se drejtorët i kanë marrë parasysh.

Avdullah Kryeziu - Hartimit të kësaj rregullore i ka parapri vendimi i kryetarit të komunës dhe në bazë të detyrave zyrtare jam caktuar nga kryetari si koordinator për hartimin e kësaj Rregullore. Kemi mbajtur takime me gjithë drejtorët e drejtorive komunale dhe secili drejtor i ka bërë propozimet për taksa, tarifa dhe gjoba për drejtoritë përkatëse, duke respektuar edhe ligjet në fuqi. Janë mbajtur 2 debate publike me qytetarë dhe rregullorja ka qenë në diskutim publikë. Të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet janë marrë nga këto debate dhe janë inkuorporuar Rregullore.

Fehmi Hoxha, Drejtor i Urbanizmit - Asgjë nuk ka ndryshuar nga propozimi i parë nga Drejtoria për urbanizëm rreth taksave dhe tarifave të cilat i kemi diskutuar së bashku para se të del në debat publikë. Më herët të gjitha tarifat kanë qenë të llogaritura në m3, në qershor të vitit 2012 është miratuar Ligji për ndërtim dhe tarifat për leje ndërtimore shndërrohen në m2 dhe njëkohësisht është nxjerr një tabelar të cilin e kemi hartuar dhe aplikuesit për marrjen e lejes ndërtimore duhet të paguajnë 1.70 €. Ka ndryshim me implementimin e rregulloreve të vjetra ma herët kanë qenë 2 tarifa, tarifa për leje ndërtimore për banim dhe për afarizëm dhe kjo e dyta mbërrin shifrën diku 5 €, kur shndërrohet nga m3 në m2 Ligji i ri nuk lejon kesi ndarje dhe në bazë të këtij tabelari del që 1.70 € është për të gjitha kategoritë. Ne jemi ndër komunat që i ka tarifat ma të lira, tek tarifat për urbanizëm. tek planifikimi hapësinorë janë bërë lehtësirat përsëri 500 €. Këto leje mjedisore jepen 1 herë për 10 vite dhe ndahen me kategori dhe të gjitha janë të lehtësuara diku rreth 50% në aspektin e përgjithshëm tek tarifat për ndërtim diku rreth 300% janë ma lirë.

Besnik Hoti - Tek neni 5 tarifa e banimit dhe tarifa e biznesit mendoj se nuk duhet të shkojnë bashkë, propozimi imë është që tarifa e banimit të jetë rreth 1 € për m2 ndërsa tarifa e biznesit mundet të jetë 1.70 € m2.

Drejtori i Urbanizmit - Unë e shpjegoj se nga qershori 2012 ka hyrë në fuqi Ligji i ri për ndërtim ku nuk i ndanë tarifat për biznes dhe tarifat për banim dhe ne nuk mundemi të bëjmë diçka kundër ligjore.

Xhihad Vuqitërna - Tek neni 4.1 taksa për dhënie e lejes mjedisore komunale, fabrikat që janë për prodhim dhe për përpunim propozoj t'i zvoglohet, kemi propozimin prej 500 € në 300 € unë propozoj të bëhet 100 €.

Flori Boshnjaku - Tek neni 4.1 kisha me propozuar prej 500 € është bërë 300 € mbase nuk ka qenë në KPF unë propozoj të jetë 400 €, tek neni 5 ndërtimi i objekteve individuale banesore unë kisha me propozua që të zbritet të bëhet 1.50 € e jo 1.70 €.

Fehmi Hoxha - Këtë tabelarë para se me vendos sot në Kuvend e kemi dërguar 3 javë ma herët në Ministri, nuk ka mundësi në bazë të shpenzimeve që bëhen tek ne që të ulet çmimi, po të ishin shpenzimet më të mëdha ende do të rritej çmimi, po të ishin shpenzimet më të vogla do zvogëloheshin.

Fatmir Iska - Tek neni 5, tarifat e vjetra që i keni paraparë dhe tash që i kemi këto propozime të reja dua ta di se a i keni zvogëluar taksat apo i keni rritë, meqenëse kemi kthyer m3 në m2, sepse banimet individuale në krahasim me këto të afarizmit janë diku rreth 95 %. Ju duhet të fokusoheni në banimet individuale banesore, të zvogëlohen diku rreth 0.40 € e tani del diku ma shtrenjtë në m2.

Fehmi Hoxha - Për afarizëm është liruar diku 3 € ndërsa për banim 0.50 €, ka qenë për m3 ndërsa tash del pak ma shtrenjtë diku 1.50 €, mirëpo sipas tabelarit të shpenzimeve duhet të jetë 1.70 € sepse sipas kësaj tabele llogaritet tabelari për shpenzime për leje ndërtimore.

Afrim Limani - Me shumë kujdes e kam lexuar Rregulloren për tarifa dhe gjoba dhe e kam bërë një analizë, disa rritje dhe disa zbritje që janë bërë këtu me të vërtetë më kanë pëlqyer.

Kryesuesi - E qesë në votim. Kush është për aprovimin e taksave, tarifave dhe gjobave në Drejtorin për urbanizëm, me 17 pro, 6 kundër dhe 2 abstenime aprovohen taksa dhe tarifa për Drejtorinë për urbanizëm, Kalojmë në drejtorin e Shërbimeve Publike Komunale.

Feim Fetoshi - Unë do i citoj disa propozime për ndryshime të cilat janë marrë qoftë nga debati publik po ashtu kanë ardhë edhe si propozime nga bizneset e që ne mendojmë se duhet të aprovohen. Në kuadër të Drejtorisë së shërbimeve publike në përgjegjësi të saj janë neni 6,7,8,9. Tek neni 6 ku është 2.50 € propozohet të jetë 2.00 € m2, tek renditja 7 është 3 € m2 ne propozojmë të jetë 2.50 € m2, tek renditja 9 taksa për gjërmim, dëmtimet e rrugëve me zhavorr mbi 50 m2 është gabimisht 60 € duhet të jetë 200 €. Nuk është kjo rritje por përkundrazi është zbritje, sepse gjithë operatorët që kanë gjërmime mbi 50 m2 paguajnë shumën 200 €, tek renditja 14 në vend të 10 € bëhet 5 €. Tek neni 7 titulli të bëhet taksa për vendosjen e objekte të përkohshme, tek renditja 1

propozimi 20 € të bëhet 10 € m², nën 2 nga 12 € të bëhet 8 € m², nën 3 nga 100 € propozimi është të bëhet 80 €, nën 4 nga 80 € propozojmë të bëhet 60 €. Tek neni 8 dhe 9 nuk ka ndryshime, mirëpres çdo sugjerim dhe propozim.

Rukije Krasniqi - A po respektohet kategorizimi i tatimit sipas zonave apo shkojnë në mënyrë uniforme, sepse nuk mundemi ti krahasojmë fshatrat me qytet dhe fshatrat e mëdha me fshatrat e malore. Po ashtu kam një propozim të lirohen nga pagesat OJQ dhe kandidatët të cilët kanë kushtet e vështira sociale për kërkesa për ndihmë materiale apo financiare.

Feim Fetoshi - Njerëzit deri më tani kanë paguar 10 € m² në qytet dhe 15 € m² në fshat, vetëm në qytetin e Rahovecit propozimi jonë është nëse ju e miratoni 10 € m² ndërsa për zonat rurale 8 € m².

Fatmir Iska - Unë nuk do të jem kundër këtyre tarifave që janë propozuar nga qytetarët e komunës së Rahovecit pavarësisht ngritjeve ose zbritje. Kërkoj një sqarim në faqen 8 propozimi i taksave për dëmtimin e rrugëve, taksa për gjurmim dëmtimin e rrugëve me asfalt prej 0-10 m², 10-20 m², 20-50m² dhe mbi 50 m², a bie nëse dëmtohet asfalti 10 m² paguan 90 € ndërsa nëse dëmtohet deri në 20 m² a zbritet ajo vlerë.

Feim Fetoshi - Së pari duhet të qitet kërkesë për dëmtim dhe dhënia e lejes nga ne përpos që e detyron të paguaj këtë taksë po ashtu e ka për obligim ta kthejë në gjendjen e mëparshme dhe për shkak se rikthimi në gjendjen e mëparshme me asfalt kushton shumë për atë arsye ne kemi shkuar që ata që dëmtojnë pak të paguajnë një taksë më të lartë, ndërsa ata që dëmtojnë më shumë të paguajnë më pak sepse ju kushton shumë ngase asfalti është i shtrenjtë për atë arsye e kemi bërë kështu.

Flori Boshnjaku - Tek neni 6 nën 4, ka qenë 0,10 € ndërsa tash është bërë 1.00 € nuk e kam të qartë.

Feim Fetoshi - Këto taksa janë për auto dyqanet lëvizëse dhe ato janë me një sipërfaqe të vogël dhe asnjëri nuk ka përmby 20 m² dhe kjo ka qenë se qysh me ja dhanë lejen ne, të rijë një kamion tërë ditën në qendër të Rahovecit dhe të paguaj 2 € dhe për atë arsye e kemi bërë 20 € mendoj se nuk është ndonjë taksë e madhe.

Kadri Dellova - Jemi dëshmitarë si në qytet ashtu edhe në fshatra që janë vërsulur operatorët e telefonisë mobile dhe të rrjetit të internetit po ashtu edhe KEK, bëjnë vendosjen e shtyllave dhe ata nuk e di apo marrin leje, vendosja e platformës së plastikës sidomos Kujtesa dhe Ipko janë duke bërë invazion në shumë vende e kanë uzurpuar trotuarin e fëmijëve dhe i kanë vendos do trafo, a paguajnë ata taksë komunës sonë për ato vende.

Feim Fetoshi - Me rregullore dhe me ligje askush nuk mund të vendos diçka në hapësirat publike pa leje, nuk po them se nuk ka ndonjë operator që punon pa leje, për këtë unë i ftoj qytetarët që nëse sheh dikë që po punon të na njoftojë në mënyrë që të del inspektorati të vepron.

Azbi Gashi - Pikërisht dje janë qitur shtyllat elektrike në rrugën ku unë banoj dua ta di se a kanë leje ata.

Feim fetishi - Në Fortesë pikërisht janë duke punuar PTK duke e shtrirë kabullin optikë dhe ata janë duke punuar me leje.

Kryesuesi - Propozoj që tek faqja 10 numri rendor 6 dhënia me qira hapësirave të mëdha publike mbi 2000 m taksë vjetore që kjo të jetë minimum 0.05 sepse kjo jepet me ankand dhe që i bie diku për hektarë 500 € në vit, por prapë se prapë këtë çështje e rregullon ankandi.

Feim Fetoshi - Kryesuesi në parim ka të drejtë deri tani ka qenë një taksë për hapësirat të mëdha është quajtur kështu, dhe ka pasë rast që dikush ka kërkuar vetëm 10 ari dhe ai e ka marr shumë lirë për atë arsye ne e kemi ndarë deri në 2 pjesë deri në 2000 m² dhe mbi 2000 m².

Kryesuesi - Nëse dëshirojmë që të afrojmë operatorë ekonomik ose investitorë të cilat janë të interesuar të investojnë në Komunën e Rahovecit duhet të jemi konkurrentë sepse kështu nuk mundemi. Suhareka e ka 0.05. e qesë në votim kush është për këto propozime që u dhanë: Është aprovuar në mënyrë unanime. Kalojmë tek Drejtoria e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural.

Lulzim Haska - Sa i përket Drejtorisë të bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural, njëri prej shkaqeve që propozimi i taksave nuk është pranuar dhe është kthyer nga ministria përkatëse për shkak disa shkeljeve që janë bërë gjatë propozimit për ndryshim. Siç e dini Ministria i ka marrë disa kompetenca të cilat i ka pas Drejtoria e bujqësisë si p.sh. dhënia e pëlqimit për ekspluatues të zhavorrit, dhënia e pëlqimit për gurëthyes, vlerësim për eksportues të zhavorrit si dhe vlerësim për përcaktimin lokacioneve për shfrytëzimin e zhavorrit. Pra, të gjitha këto kanë kaluar në ministrit përkatëse. Ne si drejtori i kemi propozuar disa tarifa të reja që në krahasim me tarifat e vjetra kanë pasuar disa zvogëlime. Tek taksa për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore kemi bërë disa ulje, tarifa e vjetër ka qenë 2 € m² ndërsa propozimi ynë është 1 € m². Kjo vlen deri tek kategoria e 4 e tokës bujqësore, ndërsa kategoria 5 dhe 6 nga 0.40 € është bërë 0.75 € m² ndërsa kategoria e 7 dhe 8 nga 0.30 € në 0.50 € m². Sa i përket dhënies së tokës komunale me qira ne jemi mbështetur në rregulloren e re mbi dhënien e pasurisë komunale, ku parashihet që të gjitha tokat që janë në posedim të komunës të jepen në shfrytëzim vetëm përmes ankandit publik, kurse dhënia e pëlqimeve dhe vërtetimeve nga bujqësia nuk ka ndryshime ka qenë 10 € prapë kemi propozuar të jetë 10 €, dhënia pëlqimit për shfrytëzimin e tokave pyjore për qëllime bujqësore ka qenë 25 € dhe prapë është e njëjtë, dhënia e vërtetimit për shitjen e prodhimeve bujqësore vetanake 5 €, ky vërtetim nxirët një herë në vit, vërtetimi që është prodhues bujqësorë gjithashtu është 5 €, parashtrimi i kërkesës Drejtorisë së bujqësisë është 1 € ka qenë 1 €, parashtrimi i ankesave nga palët 2 € ka qenë prapë mbetet 2 €, dhe dhënia e pëlqimit të shfrytëzimit të gurit gëlqeror, pra ne vetëm pëlqimin japim të tjerat ministria.

Xhihad Vuqitërna - Tek taksat për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore te kategoria e tokës klasa e parë, tarifa vjetër ka qenë 2 € ndërsa tash është bërë 1 €, në një formë ne po i lehtësojmë qytetarëve që ta shndërrojnë tokën bujqësore në tokë ndërtimore. Mendoj se ne duhet me i dekuraj shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore, propozimi im është që të rrisim pre 2 € në 4 € e jo ta zvogëlojmë.

Lulzim Haska - Sipas ligjit kjo e drejtë i takon Ministrisë së bujqësisë, ne si drejtori nuk guxojmë të lëshojmë leje se cilës kategori i takojnë tokat përveç nëse është në zonë urbane.

Selim Duraku - Vërtetimi për dëshmi që është prodhues bujqësorë nuk ka nevojë të jetë 5 € le të jetë 2 €.

Fatmir Iska - Neni 10.3 dhënia e pëlqimeve nga lëmia e bujqësisë, taksa me numër rendor 3 dhe 4 dhënia e vërtetimit për shitjen e prodhimeve vetanake dhe vërtetimin për dëshmi që është prodhues bujqësorë të dyja janë taksat nga 5 €, këtu kemi propozimin e Komitetit që taksa numër 3 dhe 4 të jetë 0 €, kërkoj që të qitet në votim dhe në këtë mënyrë ti ndihmohet sadopak bujqëve.

Florije Boshnjaku - Tek faqja 12 tek neni 10.2, ma herët e diskutuam që të jetë një shumë minimale me të vjetrën, ka qenë 1€ ndërsa tash me ankand publik a duhet që edhe këtu të japim një, shumë minimale apo jo unë kisha me thanë që të dalim edhe këtu me një shumë minimale.

Sinan Ejupi - Drejtor çka nënkuptoni me zonë urbane sepse ne nuk e dimë se çka është më zonë urbane se gjitha është urbanizua, p.sh në Fortesë toka e klasit të parë është urbanizuar.

Lulzim Haska - Ne si Drejtori kur personi përkatës kërkon ndërrim destinimit të tokës brenda kufijve të zonës urbane dhe na bie vërtetim që ka marrë edhe prej Drejtorisë së urbanizmit atëherë ne e lejojmë që të bëjë ndërrimin edhe nëse toka është e kategorisë së 1 ose të 2.

Azbi Gashi - Dy vërtetime janë që i kërkojnë bujqve nga 5 € dhe pajtona me Fatmirin që të bëhet 0 €.

Kryesuesi - Kategoria e 5 dhe 6 të jetë 0.20 € dhe kategoria e tokës 7 dhe 8 të jetë 0.10 €, prapë se prapë kjo shkon me ankand publik, por duhet të ketë një çmim minimal, dhe askund në botë nuk ka që mos të mbrohet toka pjellore dhe të shndërrohet me një çmim minimal në tokë ndërtimore dhe është e pakuptimtë të ulet nga 2 € në 1 €, përkundrazi duhet të rritet dhe të rruhet toka bujqësore. Nuk pajtohem fare që të hiqet vërtetimi për bujq nga 5 € të bëhet 2 €. Kush është për këto ndryshime të tarifave në Drejtorinë e bujqësisë, e qes në votim. Në mënyrë unanime janë aprovuar tarifat në Drejtorinë e bujqësisë. Kalojmë në tarifën për punë inspektuese.

Avdullah Kryeziu - Me tarifa të vjetra kanë qenë disa tarifa të cilat nuk korrespondojnë me ligjet e pushtetit lokal sepse korrespondojnë me ligjet e pushtetit qendror, sidomos me Agjensionin e veterinars dhe ushqimit janë hequr të gjitha ato pika ndërsa janë 8 propozimet e Drejtorisë për punë inspektuese.

Florije Boshnjaku - Kërkesa për pëlqim për punë ka qenë 5 € është bërë 15 € a është e paraparë me ndonjë akt normativ apo është propozimi i drejtorit.

Avdullah Kryeziu - Me siguri është bërë ndonjë gabim sepse dhënia e pëlqimit të punës edhe me rregullore të vjetër ka qenë 15 € po ashtu edhe tash është 15 € është bërë ndonjë gabim teknik.

Afrim Limani - Ka disa rritje dhe zbritje që janë bërë sipas dëshirash, konkretisht tek Drejtoria e punëve inspektuese. Nuk pajtohem me këtë rritje të taksave që ka bërë sidomos në pikën 3,4,5,6,7,8, tek pika 3 kërkesa për kontroll inspektues jashtë qytetit dhe subjekteve afariste, kjo shumë duhet të jetë 15 € ose 10 €, tek pika 6 kërkesa për asgjësim mallrash unë mendoj se padrejtësisht është rritë kjo shumë në 30 €, propozoj që të jetë 15 €, ndërsa në pikën 7 kërkesë për dalje në teren jashtë qytetit për PTK dhe KEDS, Radoniqin dhe Ambientin unë kisha thanë që të rritet minimum 150 € dhe kjo rritje i mbulon edhe zbritjet e këtyre kategorive tjera.

Avdullah Kryeziu - Unë pajtohem me ju sepse ju jeni ata që jepni propozimet dhe votohen propozimet e juaja, kërkesa për kontroll inspektues jashtë qytetit dhe subjekteve afariste normalisht që edhe ne bëjmë shpenzime sepse kur dilet jashtë qytetit ka shpenzime ma të mëdha, ka një arsyetim pse e ka rritë taksën ndërsa zvogëlimin në qytet e ka arsyetimin e pse e ka ulë taksën.

Kryesuesi - Kemi propozime që në pikën 3 prej 20 € të jetë 10 €, në pikën 6 prej 30 € të jetë 15 €, dhe pikën 7 prej 100 € të jetë 150 €, ndërsa pika 8 të jetë njëjtë 100 €. E qesë në votim. Kush është për këto propozime? Konstatohet se në mënyrë unanime janë aprovuar edhe tarifat për Drejtorinë për punë inspektuese. Kalojmë në Drejtorinë për kadastrë dhe gjeodezi.

Kujtim Popaj, Drejtori i gjeodezisë - Siç e dini këto tarifa janë të përcaktuara në bazë të Udhëzimit Administrativ 05/2012 dhe 08/2014, por ne si Drejtori i kemi shtuar 2 ose 3 kolona. Bëhet fjalë tek neni 14.2 kolona numër 11 incizimi i gjendjes faktike në terren për 1 orë. Këto që do i përmendi tash ne i kemi përfshi dalja e gjeodezisë në terren për 1 orë është 30 €, po ashtu tek neni 12.9 kolona numër 3 certifikata për pronën që ka ma shumë se 10 fletë i shtohet për çdo fletë nga 30 cent, po ashtu tek kolona numër 4 certifikatë për pronën për personat që janë me ndihmë sociale dhe që nuk posedojnë paluajtshmëri të lirohen nga pagesat, tek neni 13.2 kolona numër 6 ndryshohet nuk është fshirja e hipotekës por duhet të jetë ndryshimi i hipotekës.

Fatmir Iska - Teke tarifat për kadastrë drejtor të kisha propozuar që as mos shtohet por as mos heqë asgjë, ato janë të përcaktuara me Udhëzim administrativ. Ato të cilat i ke propozuar ti do të kthehen nga MAPL dhe nuk do të certifikohet rregullorja pikërisht për këto që i ke propozuar.

Florije Boshnjaku - Tek faqja numër 18 te dispozitat e veçanta 12.17 pagesat dhe shpenzimet e transportit paguhen drejtpërdrejt, si bëhet kjo, po ashtu edhe në faqen numër 25 tek neni 15.2 nga pagesat e lirit të parkingut lirohen mjetet e emergjencës, ndihmës së shpejtë dhe veteranët e luftës propozoj të lirohen edhe familjarët e dëshmorëve dhe invalid të luftës.

Kryesuesi - E qes në votim .kush është për aprovimin e taksave në këtë drejtori me këto propozimet e fundit: Në mënyrë unanime janë aprovuar tarifat dhe taksat për Drejtorinë e gjeodezisë. Kalojmë tek Drejtoria për kulturë sport dhe rini. Unë nuk pe kuptoj tek numri rendor 7 dhënia e skenës mobile për një ditë 300 €, nuk e di se çka është.

Rasim Fazliu - Tek neni 16 pika 8 anëtarësimi në bibliotekë për leximin e librave për 1 vit, unë propozoj që të jetë 1 € dhe t'i lehtësohet nxënësve që të lexojnë sa ma shumë.

Kadri Dellova - Pajtohem plotësisht që të hiqet taksa për lexim. I kam vizituar disa shtete të jashtme dhe ata aq shumë mobilizohen dhe i dërgojnë edhe nëpër shpi libra nxënësve vetëm që të lexojnë, askund në botë nuk ka që nxënësi të paguaj një taksë që të mar diçka të lexoj.

Krzesuesi - E qes në votim propozimin e taksave për kulturë me propozimet që u dhanë: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar. Kalojmë në Drejtorinë për shëndetësi.

Munib Durguti - Sa i përket çmimore për shërbime shëndetësore është kompetencë e ministrisë dhe ne aty nuk kemi kompetencë as me zvogëluar e as me ndryshuar, mirëpo është kompetencë e këshillit drejtues të QKMF që ato shërbime që nuk janë të paraparë më këtë rregullore dhe në vendimin zyrtar që ata të propozojnë dhe të marrin vendime për shërbime eventuale. Për Qendrën për punë sociale ne kemi propozuar gjithsej 11 kategori për shërbime që kryhen atje ndërkohë na ka ardhë edhe propozimi i 12 që është propozim që të futet edhe vërtetimi që nuk është përfitues i ndihmës sociale.

Kryesuesi - Unë kam një pyetje për tarifat për punë sociale tek neni 5 caktimi i emrit personal nuk po kuptoj çka është. Faleminderit nga drejtori ma sqaroj pra qenka për fëmijët që janë pa përkujdesje dhe të braktisur.

Florije Boshnjaku - Drejtori e ceku se çmimorja është caktuar në bazë të ligjit, mirëpo tek neni 17 -vërtetimet që lëshohen është mirë që drejtori të konsultohet se a kemi drejtë me ndërhy që mos të na kthehet rregullorja prapë sepse në qeverisjen tonë neve na kanë thënë gjithqysh duhet të hiqen.

Ejup Kabshi - Tek kategoritë e liruar nga lufta që jemi të liruar nga participimi në QMF, bëhet pagesa në ndërrimin e natës dhe në ditë të vikendit, pra propozoj që të jetë edhe në ndërrimin e natës dhe në ditëve të vikendit dhe raste emergjente të lirohen.

Drejtori i Shëndetësisë - Ne jemi shumë më të furnizuar ne kujdestari dhe barnat nga lista esenciale i kemi më së shumti. Nëse i heqim participimin për kategoritë që i ceke atëherë aty do të kemi një fluks shumë të madh të pacientëve, pra kjo ka qenë edhe arsyetimi ynë dhe unë jam që të jetë ashtu si është.

Luljeta Kadiri - Mbase ballafaqohem me këtë problematikë do ja kisha dhënë pak sqarim kolegut Ejup. Është shumë e arsyeshme që në rregullore nuk ekziston kjo, mirëpo duke u bazuar në QMF të komunave tjera dhe duke u ballafaquar me problemet na që i kemi me pacientë dhe me një rregullore të brendshme, është bërë që participimi të jetë 1 €. Në Prizren është 2 € për gjitha kategoritë, por nëse rasti është emergjent mjeku është ai e cili e cakton se a duhet të paguaj pra nuk e detyron, por ne në kujdestari siç e ceku drejtori po furnizohemi mjaftë mirë nga lista esenciale e barnave. Gjithë ditën e rinë me temperaturë dhe vjen në ora 9 sepse furnizohet komplet me terapi. Ky 1 € prapë nuk e kompenson terapinë që ne ia japim pacientit por është të paktën një lehtësim komunës dhe unë kisha propozuar që të jetë kështu si është.

Kryesuesi - Ju duhet të dini ai buxhet që është aprovuar, ato të hyrat vetanake duhet të plotësohen diku, dhe nëse në rregullore shkruan se veterani lirohet, nuk e di se ku janë bazuar që e kanë ngarkuar në ndërrim të natës, dhe propozoj ai vendim të shfuqizohet nga ana e drejtorit, e qesim në votim: Në mënyrë unanime është aprovuar edhe kjo rregullore për shëndetësi, kalojmë tek Drejtoria për arsim.

Behar Rama, Drejtori i DKA-së - Me gjithëse provimet me korrespondencë nuk i kemi në komunën tonë, por unë do të angazhohem që t'i kthejë prapë në funksion, sepse popullata jonë shkojnë në Suharekë, Malishevë, Prizren dhe Gjakovë, vetëm për provim me shkrim dhe me gojë janë parapa ndryshime, janë bërë 10 € sepse profesori duhet të vijë 2 herë, ndryshime tjera nuk kemi.

Kryesuesi - E qes në votim edhe këtë rregullore për drejtorin e arsimit: Në mënyrë unanime edhe kjo rregullore është votuar, kalojmë tek Drejtoria e administratës.

Selim Duraku - Tek pika numër 8 certifikata për shtetësi të Republikës së Kosovës të kthehet prej 5 € në 2 € qysh ka qenë, pika 15 certifikata për vendbanim të kthehet prej 5 € të bëhet 2 €, pika 25 të jetë 2 € ashtu si është dhe pikën 32 nuk po e kuptojë - vërtetim për akt vdekje.

Fatmir Iska - Tek faqja numër 31 taksa me numër rendor 12 propozoj të jetë si ka qenë 50 €, taksa me numër rendor 29 të jetë 1 €.

Kadri Dellova - Ne si përfaqësues të fshatit Krushë e Madhe e kemi një brengë, pse nuk lirohemi për kërkesa të komunitetit, propozoj që të lirohet çdo kërkesë që vije në emër të komunitetit në komunë.

Avdullah Kryeziu, Drejtor për ekonomi dhe zhvillim - Pjesa ma e madhe e të hyrave nga bizneset është nga Drejtoria për ekonomi dhe zhvillim. Ne duke e ditur se bizneset janë duke u ballafaquar me vështirësi dhe barriera serioze që pengojnë funksionimin e tyre sepse kemi rritjen e energjisë elektrike, rritja e shkallëve të tatimeve në gjitha llojet e bizneseve, sipas informative që i kemi në këtë vit në komunën tonë janë regjistruar diku 275 biznese të reja dhe shumica e këtyre nxënësve e kanë marrë certifikatën e biznesit vetëm për të marrë kredi në bankë ose të konkurrojnë diku për ndonjë fond. Duke u bazuar në atë se performanca e komunës matet me inkasimin e taksave, tarifave dhe gjobave të bizneseve dhe në bazë të kësaj performance komunat marrin donacion prej ministrive dhe qeverisë, ne nuk mundemi të heqim të gjitha por ne i kemi zvogëluar taksat, dhe ne si ekzekutiv do t'i propozojmë një vendim të posaçëm këtij Kuvendi nga kryetari, që të gjitha llojet e bizneseve të lirohen për një periudhë kohore. Kam me shtuar një taksë, le të jetë në fund 4d - dhënia e vërtetimit për stazh pune, për biznes para lufte dhe propozimi im është që të jetë 1 € sepse ky vërtetim i nevojitet pensionistëve. Po ashtu e kemi edhe dhënien e pronës të paluajtshme në shfrytëzim, tarifa e vjetër ka qenë 2.5 € m2 dhe Kuvendi le ta caktoj tash tarifën fillestare, sepse kjo shkon me ankand, pra le të jetë 1.5 € m2.

Afrim Limani - Kam një propozim dhe kërkoj nga kolegët e mi të më përkrahin në këtë propozim. Kërkoj që të gjitha taksat për ndërmarrje prodhuese në komunën e Rahovecit që kanë mbi 10 punëtorë të lirohen nga taksat dhe besoj se nuk do të ndikoj shumë në buxhetin e komunës.

Fatmir Iska - Tek faqja me numër 38 taksa me numër rendor 61,62,63, kemi zbritje kur dihet se poliklinika, shërbimet shëndetësore dhe farmacitë janë goxha fitim prurës dhe nëse nuk dëshirojmë ti risim le të jenë me tarifat e vjetra.

Selim Duraku - Në faqen 38 renditja numër 67 për bastorët nga 250 € të jetë në 400 €, faqe 37 renditja numër 58 - noterët nga 300 € në 1000 €, faqe 36 renditja numër 31 separacion dhe gurthyes prej 500 € në 1000 €.

Sinan Ejupi - E përkrahi propozimin e Afrimit që të hiqet taksa nga ndërmarrjet prodhuese dhe unë kisha me propozuar që të jete prej 5 punëtorëve, sepse shumë pak do të përfitojnë nga kjo, dhe me anë të kësaj do i japim një stimul që të prodhojnë më shumë.

Erlira Mullabazi - Neni 22 propozimi i parë që të gjitha taksat në biznes të ulen për 10 %, por kisha me propozuar që të përjashtohen nga kjo ulje e 10 % bankat, institucionet mikrofinanciare, kompanitë e sigurimeve të automjeteve, KEDS-i me seli në Rahovec dhe superacionet dhe gurthyesit, po ashtu edhe propozimit numër 2 propozoj që te distribucionit i energjisë elektrike të rritet nga 1000 € në 2000 €.

Fatmir Iska - Faqe numër 37 taksa me numër rendor 47 frizerë për femra nga 70 € që është të rritet në 100 €.

Arsim Kastrati - Për përkthyes të licencuar nga 100 € sa është propozoj të rritet në 150 €.

Mirjeta Krasniqi - Në faqen 36 numër rendor 36 bukëpjekësit dhe byrektorët propozoj ose të zbritet ose të lihet ashtu si është e jo të rritet, sepse nuk është diçka lukse dhe tek ata do të ndikojë që të ngritin çmimin e bukës.

Astrit Thaqi - Në faqen 38 numri rendor 70 automatet dhe klubet e veçanta nga 150 € të bëhet 500 € dhe te tombolla dhe lojërat e fatit të jetë njëjtë 500 €.

Marigona Berisha - Unë kisha me propozuar që avokatëve nga 180 € të ngritet në 200 € dhe këmbimorëve të rritet nga 100 € në 130 €.

Kryesuesi - Së pari edhe këta që i kanë propozuar nuk kanë bërë kurrfarë analize edhe ju tash si ju teket jeni duke propozuar, nuk është në rregull kjo. sepse ju jeni duke parë vetëm nga një kënd, i vetmi propozim që është në rregull është tek ndërmarrjet prodhuese, tek ata që punësojnë mbi 5 punëtorë të lirohen nga taksat.

Sinan Ejupi - Tek noterët të gjithë e dimë se sa qarkullojnë ata në ditë dhe 300 € është me të vërtetë qesharake në krahasim me disa tarifa tjera dhe nëse noteri e ka taksën 300 € dhe bukëpjekësi 120 € për mu është e pa pranueshme.

Rasim Fazliu - Unë mendoj se këtë pikë e kemi zgjatur mjaftë dhe me të vërtetë kemi folur nëpër mendsh, unë i bashkëngjitëm mendimit të mëhershëm të disa kolegëve që mos të na kthehet edhe një herë rregullorja. Drejtorët e kanë lejen prej neve që ti bëjnë ndryshimet që i kërkojnë nga ministria në mënyrë që të pranohet rregullorja.

Kryesuesi - Gjobat për shkeljen e rregulloreve lokale nuk janë të parapara.

Avdullah Kryeziu - Lartësia e gjobave është e bazuar në proporcion të dispozitave të rregulloreve komunale, kur e thashë këtë e përmenda një rregullore komunale të miratuar në vitin 2013, për orarin e punëve të bizneseve aty janë të përcaktuar dispozitat ndëshkuese, edhe tek drejtoria për urbanizëm edhe tek drejtoria për shërbime publike i ka rregulloret e posaçme komunale ku parashihen dispozitat ndëshkuese. Sa i përket propozimit të Sinanit dhe Afrimit unë ju them se në nenin 22.4 është vetëm e cekur ndërmarrjet që themelohen për veprimtari prodhuese që punësojnë mbi 5 punëtorë janë të liruar për 2 vite, pra gjitha propozimet e juaja janë këtu në rregullore po ndoshta nuk i keni parë.

Afrim Limani - Dispozitat e veçanta është fjala për ndërmarrje të reja prodhuese e jo për ato ekzistuese që janë duke funksionuar.

Kryesuesi - E qesë në votim tarifën për superracionet dhe gurëthyesit a doni që të jetë 500 €, 700 €, ose 1000 €. Kush është për 500 €? 8 për, 3 kundër. Pra mbetet 500 € ashtu si ka qenë. Kalojmë tek frizerë për femra 80 € ka qenë 70 € kemi propozim i ekzekutivit ndërsa 100 € propozim i Fatmirit e qesë në votim: pra mbetet 70 € ashtu si ka qenë. Tek rrobaqepës dhe të ngjashëm unë kam një propozim nga 35 € është bërë 50 € dhe propozimi im është të lirohet në zero, por ju po propozoni të jetë 10 € atëherë e lejmë 10 €. Kalojmë tek avokatët 250 € ka qenë dhe 250 € do të mbetet. Përkthyesit e licencuar ka qenë 120 € dhe 100 € do të mbetet. Kalojmë tek noterët 500 € mbetet. Kalojmë tek propozimi për automatet dhe klubet e veçanta 500 € mbetet. Kalojmë tek bastoret mbetet 500 €, e qesë në votim Rregulloren komplete kush është për: me 1 abstenim dhe të gjithë të tjerë për është aprovuar Rregullorja.

8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Rregullores për menaxhimin e mbeturinave.

Feim Fetoshi - Me këtë rregullore Kuvendi komunal jep një kontribut që të zbatohet ligji dhe që të kemi një mjedis pak ma të mirë. Emërtimi i nenit 4, kam një sugjerim nga Ministria që titulli të mbetet dhe ajo në kllapa të hiqet. Po ashtu edhe tek neni 5 nuk ka nevojë të shkruhet se ku është bazuar. Neni 13, taksat mbi mbeturinat pika 9.1 e kemi në kllapa caktohet aty data e kemi lënë ashtu sepse në fillim nuk e kemi ditë se kur do të bëhet dhe kemi lënë që nga 1 janari 2016 të aplikohet dhe të faturohet kjo taksë. Tek pika 9.3 gjeneruesi i mbeturinave obligohet të paguaj faturat e taksës së mbeturinave në 4 këste. Pika 9.5 nëse gjeneruesi i mbeturinave nuk paguan taksën për mbeturina sipas nenit 9 paragrafi 3 të kësaj Rregullore nuk do të ketë shërbime komunale. Tek neni 12 - komisioni këshillues përbëhet nga 5 deri në 10 anëtarë dhe sipas sugjerimit të Fatmirit dhe propozimit nga ne është që të jetë 3 deri në 7. Po ashtu edhe në nenin 12.4 pika g pagesa apo mëditja e anëtarit të komisionit këshillues duhet të caktohet sa duhet të jetë mëditja dhe ju jeni ata që e caktoni. Në nenin 17 faqe 9 pik 17.1 kjo Rregullore do të zbatohet nga 1 marsi 2015 me përjashtim të neneve 9 dhe 12 aplikimi i të cilëve fillon nga 1 janari 2016.

Kryesuesi - Pagesa e taksës mbi mbeturinën në shumën deri në 10 € bëhet në arkën komunale duhet të hiqet është propozimi im dhe të bëhet në bankë. Në faqen 7 tek neni 11.2 për shkelësit e dispozitave të kësaj rregullore inspektorët komunal bëjnë dënime mandatorë varësisht nga lloji i shkeljes prej 5 € deri në 100 €, është e pa kuptimtë mendoj unë dhe duhet të jetë shqiptojnë dënime mandatorë, dhe unë kisha me propozuar që të fillojë prej 20 € e jo prej 5 €. Tek 12.3 termin ekspertë akademik unë nuk e kuptoj se çka është dhe kisha pas dëshirë që të ma shpjegoni.

Feim Fetoshi - Ekspertë akademik sepse këtu bëhet fjalë për një komision këshillues, këtu i ofrohet mundësia njerëzve të qëllimit të mirë të cilët dëshirojnë të kontribuojnë për mesin e vetë.

Kryesuesi - Tek 12.4 pagesa e mëditjes së anëtarit është në euro, duhet të ndryshohet dhe të bëhet sipas depozitave ligjore në fuqi të Ligjit mbi menaxhimin e financave lokale. Në faqen 8 komisioni këshillues duhet të mbaj takime një herë në 3 muaj, propozimi im është të bëhet një herë në 6 muaj dhe ti bjen raportet 6 mujore në Kuvend. Në pikën 13.1 ngarkohet me pagimin e dyfishtë të faturës, nëse behët me këste atëherë nuk mundesh ta ngarkosh me pagimin e dyfishtë të faturës. Tek neni 17 pika 17.2 thotë për zbatimin e kësaj rregullore kujdeset kryetari komunës, Drejtoria për shërbime publike dhe Drejtoria inspektuese. Propozoj që të hiqet aty ku thuhet të kujdeset kryetari i komunës.

Feim Fetoshi - Tek mëditja pajtohem të jetë ashtu si propozoni ju, por më së miri kishte me qenë të jetë sipas dispozitave në fuqi, ndërsa sa i përket pagesës në arkat e komunës kjo i mundëson qytetarëve që ata që kanë ti paguajnë 10 € mos e paguajnë 1.50 € për shërbime bankare, po ashtu është e mirë që të bëhet lekturimi i rregullores. Sa i përket takimeve që propozoi kryesuesi që të behët një herë në 6 muaj, nëse bëhet një herë në 6 muaj i bie efekti i këtij komisioni këshillues.

Sinan Ejupi - Faqe 8, neni 13 pika 13.1 - gjeneruesi që nuk i përmbahet afatit të pagesës sipas kësaj rregullore ngarkohet me pagimin e dyfishtë të vlerës së faturës, unë mendoj se kjo është e tepërt.

Feim Fetoshi - Ideja është ata që nuk e paguajnë të detyrohen të paguajnë nëse jo i dyfishohet nëse kalon afati i mos pagesës së faturës.

Afrim Limani - Është i padrejtë ky dyfishim, por ka modele të ndryshme që munden të aplikohen për gjobë edhe për kamatën ne kemi modelin ma të mirë dhe që mundemi me marrë si shembull është tatimit në pronë.

Ejup Kabashi - Jemi pak me vonës sa i përket kësaj rregullore, në vitin 2016 unë e di se Eko regjioni e pushon aktivitetin e vet dhe komplet kompetencat i kalon komunës. Me gjithë vërejtjet që i patën kolegët, unë pajtohem që kjo rregullore të kalon. Viti 2016 komunën e Rahovecit duhet ta gjejë me planifikim buxhetor deri sat ë filloj me vjeljen e taksave tarifore që do vije nga ana e Kuvendit.

Flori Boshnjaku - Unë kam propozuar edhe atëherë edhe tash që së pari duhet të ndryshohet Statuti, të formohet edhe një sektor për mbeturina, sepse pa u formuar ky sektor dhe pa u nda buxheti mendoj se asgjë nuk është bërë. Kam një pyetje për drejtorin. Në faqen 2 ku thuhet: mbeturina komunale, mbeturinat nga ambjentit dhe mbeturinat nga aktivitetet tjera, nër të cilën nër shkak të

natyrës së tyre janë të ngjashme me atë të amvisërisë, ndërsa tek neni 5 është fjala për mbeturinat e ngurta. Dua ta di a po e merr prapë për obligim komuna edhe për mbeturinat e ngurta. Tek faja 4 neni 5 pika 5.7 dorëzimi i raportit tek MPH bëhet deri me 31 mars për vitin pasues, tek kjo rregullore komuna a ka plan për menaxhimin e mbeturinave, tek neni 9 thotë se deri me 31 mars duhet të dorëzohen faturat ndërsa në anën tjetër thotë se deri me 30 mars duhet të kryhet kësti i parë.

Feim Fetoshi - Neni 5.7 e obligon Drejtorinë e shërbimeve publike - sektorin për mbeturina që me 31 mars të vitit 2016 të dorëzoj raportin, ndërsa plani 1 vjeçar dhe 5 vjeçar komunal për mbeturina do ti vijë Kuvendit komunal në shtator së bashku me propozimin për tarifa, ndërsa tek ajo se deri me 30 mars duhet të kryhet kësti i parë është gabim teknik.

Sinan Ejupi - Mbeturina në hyrje të Rahovecit a do i pastroj dikush se me të vërtetë është një pamje shumë e keqe për qytetin e Rahovecit.

Feim Fetoshi - Komuna ka ndarë 20.000 € buxhet për mënjanimin e mbeturinave inerte, ne jemi duke punuar me Ministrinë e mjedisit që ta bëjë legalizimin e asaj deponie dhe në momentin kur do të bëhet legalizimi atëherë do të xhindet një operator për mirëmbajtje.

Rukije Krasniqi - Në faqe 6 neni 9.5 nëse gjeneruesi i mbeturinave nuk paguan këstet sipas afateve të përcaktuara të nenit 9 paragrafi 3 të kësaj rregullore, nuk do të merr shërbime komunale administrative nga 4 drejtori, po ashtu edhe nga zyra e prokurimit. Ju drejtor në mandatin e kaluar keni qenë kritikuesi më i madh i kushtëzimit të qytetarëve, ku mbeti tash ajo ndjeshmëria e juaj si kritikues.

Feim Fetoshi - Kushtëzimi që ka qenë ma herët ka qenë kushtëzim kundërligjor sepse Kuvendi ka marrë miratim për ndihmë një operatori tjetër të jashtëm, ndërsa me këtë rregullore që ju do ta votoni nga 1 janari i vitit 2016 komuna do të inkason vet, me të njëjtën të drejtë që ka komuna me kushtëzua qytetarin për tatim në pronë, të njëjtën të drejtë do ta shfrytëzoj edhe për mbeturina.

Kryesuesi - E qes në votim edhe këtë pikë të rendit të ditës me disa propozime për ndryshime që janë dhanë: Konstatoj se me shumicë votash është aprovuar edhe kjo pikë e rendit të ditës.

9. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozimit të komisionit ad-hoc për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit për fshatin Hoqë e Madhe.

Ka qenë i formuar komisioni ad-hoc nga Kuvendi i komunës, ka qenë afati kohor i mjaftueshëm sipas Udhëzimit administrativ në dispozicion të qytetarëve për të aplikuar për këshillin për fshatin Hoqë e Madhe. Gjatë procedurës së aplikimit kanë aplikuar 7 persona nga komuniteti serb një, nga kisha ortodokse serbe një dhe 2 nga komuniteti shumicë shqiptar. Komisioni pas vlerësimit të aplikacioneve 3 aplikues janë përjashtuar sepse nuk i kanë plotësuar kriteret ndërsa 4 aplikues i kanë plotësuar kriteret nga komuniteti serb dhe u janë dërguar kryesisë së fshatit Hoqë e Madhe që të përcaktohet për 2 emra. Fshati i Hoqës së Madhe është përcaktuar për 2 emra dhe ja ka kthyer Kuvendit për aprovim dhe këto emra janë: Bojan Pavloviq dhe Nenad Stasiq nga Hoqa e Madhe. Po ashtu edhe kisha ortodokse e ka propozuar Marko Dikliq për anëtar të këtij këshilli. Komisioni Ad-hoc i ka vlerësuar si të rregullta edhe aplikacionet e Esad Haxhijahës nga Rahoveci dhe Xhafer Kastratit nga Radosta. Detyrat dhe përgjegjësitë e këtij këshilli janë të përcaktuara me ligj. Mandati i anëtarëve korrespondon me mandatin e këshilltarëve komunal, vendimi hynë në fuqi pas aprovimit të Kuvendit dhe pas konstatimit të ligjshmërisë nga MAPL.

Rasim Fazliu - Me qenë se mandati i tyre është sa i kuvendarëve, dua ta di sa do të jenë të ardhurat e tyre.

Kryesuesi - Kompensimi i anëtarëve të këshillit bëhet njëjtë si i anëtarëve të Kuvendit, por Kuvendi komunal me një kërkesë i drejtohet Ministrisë së financave që të merr një buxhet shtesë për pagat e anëtarëve të këshillit dhe të administratorit si dhe për pajisjen e zyrës së tyre.

Bahtjar Hoti - Desha të pyes për këtë Marko Dikliqin, a është nga kisha ortodokse shqiptare apo serbe, dhe nëse është nga kisha serbe është dashur të shkruash që është nga kisha serbe sepse ne kemi edhe kishë ortodokse shqiptare. I kisha lutë kolegët që të mos e votojnë këtë pikë të rendit të ditës dhe le ta procedon MAPL.

Kryesuesi - E qes në votim këtë pikë të rendit të ditës: Konstatoj se është aprovuar me shumicë të votave nga ana e delegatëve që janë prezent.

10. Pyetje dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve.


Ejup Kabashi - Kam një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike. Pse nuk funksionon ndriçimi nëpër fshatra me qenë se gjithçka është në rregull, vetëm poqët janë të prishura dhe e kisha lutur që të ndërmer masa. Po ashtu kam një pyetje për drejtorin e shëndetësisë pse nuk ka vaksina në ambulancë.

Fatmir Iska - Kam një pyetje për kryetarin e komunës lidhur me subvencionimin e vreshtarëve kur e dimë se vreshtarët kanë marrë vetëm një pjesë të subvencionimit, çka ka bërë kryetari i komunës në këtë drejtim.

Rukije Krasniqi - A do të bëhet shtimi i qarkullimit të autobusëve për relacionin Rahovec-Gjakovë me qenë se Rahoveci ka kaluar në regjionin e Gjakovës. Kjo është një kërkesë nga studentet dhe nxënësit që vijnë studimet dhe mësimet në Gjakovë. Po ashtu kam edhe një pyetje, në Krushe të Madhe është bllokuar një rrugë që nga pas lufta, a ka mundësi që të zhblokohet ajo rrugë, sepse aty janë të bllokuara pothuajse 20 familje.

Mbledhja e kuvendit ka përfunduar në ora 17.50.

Procesmbajtësi,
Fahredin Sharku



-III- Nr. i prot. 2102 Më 30.01 2015
Br. prot. Dt. 2015
RAHOVEC - ORAHOVAC



Kryesuesi,
Nahit Elshani